

Në bazë të nenit 23 paragrafit 5 të Ligjit për Arsimin e Mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 229/20), Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

K A L E N D A R PËR ORGANIZIMIN E VITIT SHKOLLOR 2023/2024 NË SHKOLLAT E MESME PUBLIKE

Neni 1

Me këtë kalendar përcaktohet organizimi i vitit shkollor në shkollat e mesme publike në përputhje me njësitë programore në vitin shkollor: gjysmëvjetori, format e tjera të veprimtarisë edukativo arsimore dhe pushimet e nxënësve për vitin shkollor 2023/2024.

Neni 2

Viti shkollor në shkollat e mesme publike fillon më 1 shtator 2023 dhe përfundon më 31 gusht 2024

Viti shkollor fillon më 1 shtator 2023 dhe përfundon më 10 qershor 2024 me përjashtim të nxënësve të vitit të fundit të arsimit të mesëm-gjimnazit, arsimit profesional me kohëzgjatje katërvjeçar dhe trevjeçar, arsimit artistik dhe arsimit të mesëm profesional për nxënësit me nevoja ndryshe për të cilët mësimi i rregullt përfundon më 17 maj 2024.

Neni 3

Viti shkollor përbëhet nga dy gjysmëvjetora - gjysmëvjetori I dhe II.
Gjysmëvjetori i parë fillon më 1 shtator 2023 dhe përfundon më 29 dhjetor 2023.
Gjysmëvjetori i dytë fillon më 22 janar 2024 dhe përfundon më 10 qershor 2024.

Neni 4

Gjatë vitit shkollor nxënësit përdorin pushimet dimërore, pranverore dhe verore.
Pushimi dimëror fillon më 30 dhjetor 2023 dhe përfundon më 19 janar 2024.
Pushimi pranveror fillon më 29 prill 2024 dhe përfundon më 6 maj 2024.
Pushimi verorë fillon më 11 qershor 2024 dhe përfundon më 31 gusht 2024.

Neni 5

Për nxënësit e viteve të fundit të arsimit të mesëm, të cilët do t'i nënshtrohen maturës shtetërore, maturës shkollore ose provimit përfundimtar në periudhën e provimeve të qershorit, shkollat e mesme publike në periudhë prej 18 maj deri më 31 maj të vitit 2024 do të organizojnë orë përgatitore, konsultime dhe forma të tjera ndihme për nxënësit që duhet t'i nënshtrohen provimeve, interne dhe përfundimtare të maturës.

Për nxënësit nga paragrafi 1 i këtij neni, shkollat e mesme shtetërore në kohëzgjatje prej 18 maj deri më 31 Maj 2024 do të organizojnë orë përgatitore, konsultime dhe forma të tjera ndihme për nxënësit që duhet t'i nënshtrohen provimeve korigjuese, provimit të vitit, provimet plotësuese, provimet për avancim më të shpejtë.

Për nxënësit nga paragrafi 2 i këtij neni dhënia e provimeve korigjuese, provimet e vitit, provimet plotësuese dhe provimet për avancim më të shpejtë në afatet e provimit të majit do të organizohen në

kohëzgjatje prej datës 18 maj deri më 31 maj 2024

Për nxënësit e viteve të fundit të arsimit të mesëm, të cilët do t'i nënshtrohen maturës shtetërore, maturës shkollore ose provimit përfundimtar në periudhën e provimeve të gushtit, shkollat e mesme publike nga data 18 qershor deri më 28 qershor 2024 do të organizojnë orë përgatitore, konsultime dhe forma të tjera ndihme për nxënësit që duhet t'i nënshtrohen provimeve korrigjuese, provimit të vitit, provimet plotësuese, provimet për avancim më të shpejtë, provimet interne dhe përfundimtare të maturës.

Për nxënësit nga paragrafi 4 i këtij neni, dhënia e provimeve korrigjuese, provimet e vitit, provimet plotësuese dhe provimet për avancim më të shpejtë në afatet e provimit të qershorit do të organizohen në kohëzgjatje prej datës 18 deri më 28 qershor 2024.

Shkollat e mesme publike në periudhën prej datës 11 qershor deri më 26 qershor 2024 dhe prej datës 12 gusht deri më 20 gusht 2024 për nxënësit e vitit të parë, të dytë dhe të tretë organizojnë orë përgatitore, konsultime dhe forma të tjera ndihme për nxënësit që duhet t'i nënshtrohen provimeve korrigjuese, provimit të vitit, provimet plotësuese dhe provimet për avancim më të shpejtë.

Për nxënësit nga paragrafi 6 i këtij neni, dhënia e provimeve korrigjuese, provimit të vitit, provimet plotësuese dhe provimet për avancim më të shpejtë në afatet e provimit të qershorit do të organizohen prej datës 11 deri më 26 qershor 2024, ndërsa në afatet e provimit të gushtit do të organizohen prej datës 12 gusht deri më 20 gusht 2024

Neni 6

Provimet eksterne nga provimi i maturës shtetërore në arsimin e mesëm-gjimnazin dhe arsimin profesional katërvjeçar në periudhën e provimeve të qershorit realizohen në këto afate:

- Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke më 1 qershor 2024, duke filluar nga ora 10:00;**
- Gjuha Angleze, Gjuha Frënge, Gjuha Gjermane, Gjuha Ruse dhe Matematika më 8 qershor 2024 duke filluar nga ora 10:00.**

Për nxënësit nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilët në afatet e provimit të qershorit nuk kanë dhënë një pjesë ose të gjitha provimet e maturës shtetërore në arsimin e mesëm- gjimnazin dhe atë profesional katërvjeçar, ose për arsye të arsyeshme nuk e kanë dhënë provimin e maturës shtetërore ose pjesë të provimit të maturës shtetërore në arsimin e mesëm- gjimnazin dhe arsimin profesional katërvjeçar në afatet e provimeve të qershorit, në muajin gusht organizohet afati i dytë i provimit në këto afate:

- Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke më 12 gusht 2024, duke filluar nga ora 10:00;**
- Gjuha Angleze, Gjuha Frënge, Gjuha Gjermane, Gjuha Ruse dhe Matematika 14 gusht 2024 duke filluar nga ora 10:00;**

Provimet eksterne nga matura shtetërore në arsimin artistik në periudhën e provimeve të qershorit realizohen në këto afate:

- Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke më 1 qershor 2024 duke filluar nga ora 10:00;**
- Gjuha angleze, Gjuha Frënge, Gjuha Gjermane, Gjuha Ruse, Filozofia, gjegjësisht Estetika më 8 qershor 2024 duke filluar nga ora 10:00.**

Për nxënësit nga paragrafi 3 i këtij neni, të cilët nuk kanë dhënë një pjesë ose të gjitha provimet e maturës shtetërore në arsimin artistik në periudhën e provimeve të qershorit ose për arsye të arsyeshme nuk kanë dhënë provimin e maturës shtetërore ose një pjesë të provimit të maturës shtetërore në arsimin artistik në periudhën e provimeve të qershorit organizohet provimi i dytë në muajin gusht në afatet në vijim:

- Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke më 12 gusht 2024 duke filluar nga ora 10:00; -**

Gjuha angleze, Gjuha Frënge, Gjuha Gjermane, Gjuha Ruse, Filozofia, gjegjësisht Estetika më 14 gusht

2024 duke filluar nga ora 10:00.

Provimet interne nga pjesa me zgjedhje e provimit të maturës shtetërore realizohen në afate të përcaktuara nga komisioni i maturës shkollore me propozimin e komisioneve lëndore përkatëse të shkollës, edhe atë:

- në periudhën e provimeve të qershorit në periudhën 18 qershor deri më 28 qershor 2024 dhe
- në periudhën e provimeve të gushtit në periudhën nga 15 gusht deri më 19 gusht 2024.

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese për nxënësit e arsimit të mesëm-gjimnazit, arsimit të mesëm profesional dhe të arsimit të mesëm artistik realizohet në periudhën prej 1 prillit deri më 15 maj 2024 dhe prej 19 gushtit deri më 26 gusht 2024

Neni 7

Matura shkollore në arsimin e mesëm-gjimnazit, matura shkollore në arsimin e mesëm artistik dhe provimi përfundimtar në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar realizohen në dy periudha të provimeve, edhe atë: në muajin qershor dhe gusht.

Në periudhën e provimeve të muajit qershor:

- pjesa e detyrueshme (Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke) më 11 qershor 2024, duke filluar nga ora 10:00.
- pjesa e detyrueshme (Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke) më 15 gusht 2024, duke filluar nga ora 10:00.

Provimi nga pjesa zgjedhore e provimit të maturës shkollore në arsimin e mesëm-gjimnazit dhe në arsimin e mesëm artistik, provimi nga pjesa zgjedhore e provimit përfundimtar në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar dhe detyra e projektuese realizohen në afate të përcaktuara nga komisioni i maturës së shkollës me propozimin e komisioneve lëndore përkatëse të shkollës, edhe atë:

- në periudhën e provimeve të qershorit prej datës 18 qershor deri më 28 qershor 2024 dhe
- Në periudhën e provimit të gushtit: -

pjesa e detyrueshme (Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke) më 15 gusht deri më 19 gusht 2024.

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese për nxënësit e arsimit të mesëm-gjimnazit, arsimit të mesëm profesional dhe të arsimit të mesëm artistik realizohet në periudhën prej datës 1 prillit deri më 15 maj 2024 dhe prej datës 15 gusht deri më 19 gusht 2024.

Neni 8

Provimi përfundimtar në arsimin e mesëm profesional trevjeçar realizohet në tri afate: qershor, gusht dhe janar.

Në afatin e qershorit:

- Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke, më 11 qershor 2024, duke filluar nga ora 10:00.

Në afatin e gushtit:

- Gjuhë dhe letërsi Maqedone, Gjuhë dhe letërsi Shqipe, gjegjësisht Gjuhë dhe letërsi Turke, më 15 gusht 2024, duke filluar nga ora 10:00.

Në afatin e janarit - gjatë pushimeve dimërore të nxënësve.

Puna praktike individuale në arsimin profesional trevjeçar kryhet sipas afateve të përcaktuara nga komisioni i maturës shkollore me propozimin e komisioneve lëndore përkatëse të shkollës.

Neni 9

Puna edukativo-arsimore për nxënësit organizohet gjatë gjithë javës së punës.

Neni 10

Gjatë vitit shkollor në shkollat e mesme publike, në vitin e fundit të arsimit realizohen së paku 155 ditë mësimore dhe për të gjitha vitet e tjera të arsimit realizohen të paktën 170 ditë mësimore.

Neni 11

Në ditën e shkollës organizohen ngjarje kulturore, sportive dhe të tjera.

Dita tradicionale e arsimimit për pjesëtarët e komuniteteve që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga Gjuha Maqedone shënohet me organizimin e manifestimeve kulturore dhe të tjera.

Dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimimit për pjesëtarët e komuniteteve që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga Gjuha Maqedone, janë ditë mësimore kur zhvillohen programe të veçanta.

Neni 12

Ditët e punës kur kryhen ekskursionet e nxënësve dhe dita e shkollës janë ditë mësimore kur realizohen programe të veçanta. Për nxënësit të cilët nuk ndjekin ekskursionet, shkolla organizon mësim të rregullt në përputhje me orarin mësimorë

Neni 13

Praktika feriale realizohet në varësi të specifikës së drejtimit arsimor dhe realizohet gjatë pushimeve verore të nxënësve.

Neni 14

Me ditën e fillimit të realizimit të këtij kalendari, pushon të vlejë kalendari për organizimin e vitit shkollor 2023/2024 në shkollat e mesme publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 167/23).

Neni 15

Ky kalendar hyn në fuqi në ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Doc. Dr. Jeton Shaqiri

Numër

13-14094/1

29.12.2023

Shkup